



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW BODY

---

## PLANI PËR INTEGRITET (2024 – 2026)

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**

Prishtinë, 2024

## PËRMBAJTJE



*(Kjo plotësohet varësisht prej përshkrimit të Planit me të dhëna të tjera, si shembujt e mëposhtëm)*

1.	Hyrja.....	3
2.	Deklarata e Integritet .....	4
3.	Parimet e menaxhimit të Integritetit .....	5
3.1	Lidershipi .....	5
3.2	Përfshirja e personelit .....	5
3.3	Qasja sistemore.....	5
4.	Objektivat e Planit të Integritetit.....	5
5.	Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit .....	6
5.1	Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit .....	6
5.1	Metodologjia e vlerësimit të rrezikut.....	7
5.1.1	Matrica vlerësimit të rrezikut .....	7
5.1.1	Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut.....	8
6.	Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi .....	8
7.1	Fushat e përgjithshme të Rrezikut .....	9
7.2	Fushat specifike të rrezikut .....	9

## 1. Hyrja

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/I-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Organi Shqyrtues i Prokurimit-OSHP me datën 26.01.2024, ka hartuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i integritetit është një document brendshëm tre (3) vjeçar dhe përditësohet çdo vit. Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmërisë së integritetit brenda Institucionit dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të Institucionit.

Plani rithekson përkushtimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit- OSHP për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të Organit Shqyrtues të Prokurimit- OSHP.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të insitucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

## 2. Deklarata e Integritetit

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka bërë hapa të rëndësishëm përmes reformave të brendshme të këtij Institucioni, sidomos në drejtim të ngritjes së kapaciteteve profesionale, të domosdoshme lidhur me plotësimin e detyrimeve të cilat mes tjerash i referohen dhe Planit Kombëtar për Integrim. Procesi i reformës, i orientuar apriori në parimet e punës profesionale ka krijuar efekte pozitive dhe në procesin e implementimit të mandatit të këtij Organi, sikurse parashihet në mënyrë specifike me Kreun V, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, duke i evidentuar në këtë rast një serë angazhimesh konstante në kontekstin e bashkëpunimit të brendshëm dhe ndërkombëtar, dukem i nënkuptuar dhe aktivitetet luftës kundër korrupsionit. Krahas tjerash progresi i arritur deri më tani përfshinë dhe trajnimin të punonjësve të administratës dhe ndryshimin e akteve nën-ligjore të këtij institucioni, të domosdoshme në kontekst të progresit përfshirë: a) plotësim/ndryshimin e Rregullores se punës se punës se OSHP; b) Përpilimi [në proces e sipër] i Rregullores për komunikim me publikun; c) Rregullores për ekspert; d) Kodi i Etikës profesionale.

Sidoqoftë, ky Plan integriteti pasqyron përpjekjen e vazhdueshme të këtij Institucioni për të ngritur besimin publik, duke i zbatuar gjithnjë si parime udhëzuese transparencën, barazinë, integritetin, përgjegjësinë dhe kulturën institucionale si vlera themelore, të cilat janë sanksionuar në parimet bazë të nenit 1 të Ligjit të cituar.

Megjithatë, përballja me perceptimin e opinionit vazhdon të pranohet si një sfidë e vazhdueshme, së paku për faktin se, natyra e punës objektivisht e determinon një perceptim të tillë. Megjithatë roli aktiv i Organi Shqyrtues i Prokurimit në kontakte të vazhdueshme mes tjerash dhe me mediumet e informimit publik, ka promovuar objektivitetin dhe transparencën, sidomos ndaj operatoreve ekonomik dhe autoriteteve kontraktuese.

Me zbatimin e këtij Plani, Organi Shqyrtues i Prokurimit synon të arrijë në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitet, efektivitet, transparencë dhe etikë gjatë arritjes së rezultateve të synuara, përfshirë këtu shërbimet më të përmirësuar për operatorët ekonomik dhe autoritetet kontraktuese. Plani mbështetet në rezultatet e një planifikimi gjithëpërfshirës për integritetin dhe të një procesi të vlerësimit të rrezikut të bërë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Pra, ky Plan Integriteti do të përfshij risqet e integritetit sipas fushave funksionale të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe aktivitetet konkrete për adresimin e tyre. Qëllimi tij është përmirësimi i politikave, rregullave, praktikave të parandalimit të korrupsionit, si dhe forcimi i rezistencës institucionale ndaj shkeljeve të integritetit. Plani i Integritetit për institucionin tonë do të ndikojë pozitivisht dhe drejtpërdrejtë në forcimin institucional në kuadër të luftës efektive kundër korrupsionit. Prandaj, zbatimi i plotë i Planit të Integritetit do ta çojë administratën e Organit Shqyrtues të Prokurimit një hap më pranë përmbushjes së atyre standardeve që dëshirojmë të gjithë.

Vjosa Gradinaj Mexhuani  
Kryetare e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik





### **3. Parimet e menaxhimit të Integritetit**

#### **3.1 Lidershipi**

Menaxhmenti i lartë duhet në mënyrë të dukshme të demonstrojë një përkushtim aktiv të bazuar në fakte për integritetin. Kjo do të kërkonte nga ata që të udhëheqin procesin qysh nga fillimi, përmes zhvillimit të politikave të integritetit. Është shumë e rëndësishme që ky përkushtim të jetë i vazhdueshëm në mënyrë që të kuptohet dhe të shihet mirë nga të gjitha palët e interesit, të jashtme dhe të brendshme.

#### **3.2 Përfshirja e personelit**

Është shumë e rëndësishme pjesëmarrja e secilit punëtor në zbatimin e suksesshëm të sistemit për menaxhimin e integritetit. Megjithatë, përfshirja kuptimplote kërkon edukimin e përshtatshëm dhe trajnimin lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me integritetin, ngritjen e vetëdijes duke krijuar kështu besim dhe mjedis pozitiv për punë. Komunikimi efektiv i jashtëm dhe i brendshëm dhe koordinimi janë të rëndësishme për punë të suksesshme ekipore në mënyrë që të gjitha palët e përfshira të marrin dhe të mbajnë të njëjtin kuptim për projektin derisa është duke u zbatuar.

#### **3.3 Qasja sistemore**

Identifikimi i fushave potenciale të korrupsionit dhe menaxhimi i proceseve të ndërlidhura për të siguruar integritet kërkon qasje sistemore. Kërkohej nga organizatat që të kushtojnë vëmendje të gjitha komponentëve të sistemit dhe të analizojnë marrëdhënien dhe ndërvlerësinë ndërmjet tyre.

### **4. Objektivat e Planit të Integritetit**

Objektivi kryesor i Planit të Integritetit është të rrisë dhe të rendisë përpjekjet dhe burimet për të zvogëluar/eliminuar në mënyrë progresive dhe sistematike shkaqet dhe efektet shkatërruese të korrupsionit dhe të sjelljeve jo etike.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një platforme ku të gjithë individët dhe njësitë në OSHP si dhe akteret tjerë mund të përfshihen në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në punën e organeve të OSHP
- Krijimi i vetëdijes së publikut mbi rreziqet e korrupsionit, sensibilizimi i qytetarëve dhe bizneseve për rolin e tyre në zvogëlimin/eliminimin e korrupsionit dhe sjelljeve jo etike.

- Përmirësimi i raportimit të rasteve të korrupsionit dhe sjelljeve jo etike në OSHP.
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve në sektorin publik dhe privat.
- Krijimi dhe mirëmbajtja e partneriteteve në luftën kundër korrupsionit dhe sjelljeve jo etike si dhe forcimi i sundimit të ligjit.

## 5. Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Plani i Integritetit është një dokument që vlerëson ligjshmërinë e punës, integritetin institucional, pajtueshmërinë dhe mënyrën se si institucioni dhe punonjësit e tij veprojnë përmes vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve, ndaj ndodhjes dhe zhvillimit të korrupsionit dhe / ose sjelljeve tjera të papranueshme etike dhe profesionale.

Plani i Integritetit kryesisht përbëhet nga:

- Regjistrimi i cenueshmërisë të identifikuar dhe të vlerësuar për të gjitha fushat e funksionimit të OSHP-se.
- Përcaktimi i masave për përmirësimin e integritetit që përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet të zbatohen për të zvogëluar cenueshmërinë e integritetit, si dhe afatin kohor përkatës dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e masave.

Me rastin e zhvillimit të Planit të Integritetit bëhet vlerësimi i cenueshmërisë së integritetit për të gjitha fushat e funksionimit të OSHP-së. Të gjithë të punësuarit kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vlerësimin e rrezikut të fushave të funksionimit të OSHP-së, dhe të propozojnë masa për të përmirësuar integritetin dhe cilësinë e përgjithshme të menaxhimit si dhe ofrimin e shërbimeve.

### 5.1 Fazat e zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa fazave si në vijim:

- **Faza e parë:** Drejtuesi/personi përgjegjës të institucionit merr vendim për emërimin e një Koordinatorit dhe Grupit Punues për hartimin e Planit të Integritetit. Ky grup pune përbëhet nga një numër i arsyeshëm anëtarësh, në varësi të kompleksitetit të institucioni ose numrit të punonjësve. Grupi punues shqyrton kornizën ligjore (rregulloret, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës).
- **Faza e dytë:** Grupi punues përpilon pyetësin gjithëpërfshirës, si dhe mund të realizojë intervista me qëllim të përpunimit të sondazhit të vetëvlerësimit. Mbi bazën e rezultatit të pyetësit, përcaktohen fushat e rrezikut dhe identifikimi i rreziqeve.


Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojnë/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.





### 5.1.1 Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të dëmtimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 – 15 pikë	16 - 48	49 - 100

 Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

 Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

 Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

## 6. Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës brenda institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda një institucion, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.



## 7. Fushat e rrezikut

### 7.1 Fushat e përgjithshme të Rrezikut

#### Fushat e përgjithshme të rrezikut shembull janë:

- Fusha e menaxhimit financiar;
- Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit;
- Komunikimi dhe informimi;
- Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumenteve

### 7.2 Fushat specifike të rrezikut

Fushat specifike mund të ndryshojnë varësisht nga specifikat e Institucionit.

#### Fushat e specifike të rrezikut shembull janë:

Përditësimi dhe avancimi i kornizës ligjore të prokurimit publik;  
Avancim në monitorim të aktiviteteve të prokurimit dhe administrimit të menaxhimit të kontratave;  
Operim i qëndrueshëm dhe avancimi i sistemit të prokurimit elektronik;  
Ngritjen e kapaciteteve në prokurim publik nëpërmjet trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm.

Planit i Integritetit									
Fushat e përgjithshme të rrezikut									
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut			
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit	
<b>MENAXHIMI BURIMEVE NJERZORE</b>	Mungesa e kapaciteteve të stafit		5	8	40	Rritja e numrit të stafit	Burimet njerëzore	Ne vazhdimësi	
	Mungesa e analizës për trajnimin e stafit		4	8	32	Hartimi i planit të trajnimeve të stafit të OSHP-se	Burimet njerëzore	Ne vazhdimësi	
<b>TRANSPARENÇË N</b>	Mungesa e transparencës në publikimin e ankesave, ekspertizave dhe vendimeve të OSHP-se		2	7	14	Publikimi i vendimeve sipas rregullores së punës së OSHP-se.	Zyrtari i IT-se	Ne vazhdimësi	
	Opinionet negative publike dhe humbja e besimit		6	9	54	Komunikimi i vazhdueshëm me media, OSHC dhe akterët tjerë	Zyrtari komunikim me media	Ne vazhdimësi	

KONSULTIMIN PUBLIK	Mungesa e konsultimit me akteret ne procesin e hartimit legjislaconit sekondar te OSHP-se		2	6	12	Ruajtja e integritetit te ekspertit shqyrtues, profesional dhe teknik te OSHP-se.	Bordi i OSHP-se	Ne vazhdimësi
						Përfshirja e aktereve ne procesin e konsultimit publik.  Publikimi ne web faqe te OSHP-se.		
PLANIFIKIMIN DHE MANXHIMIN E BUXHETIT	Mungesa e planifikimit adekuat buxhetit te OSHP-se		3	9	27	Përfshirja e divizioneve ne planifikimin e buxhetit	ZKF-ja	Ne Vazhdimësi
	Mos raportimi i rregullt mbi shpenzimet financiare		3	8	24	Raportimi i rregullt mbi shpenzimet financiare te OSHP-se	ZKF-ja	Ne Vazhdimësi
	Mungesa e transparencës mbi shpenzimet financiare		3	7	21	Publikimi i raporteve financiare ne web faqe te OSHP-se.	ZKF-ja	Ne Vazhdimësi

Fushat e veçanta të rrezikut								
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
KORRUPSIONIN	Mungesa e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim	Ligjet dhe aktet nënligjore; Raportet periodike; aktet e brenshme rregulluese	2	8	16	Krijimi i kushteve të favorshme për funksionimin e zyrtarit sinjalizues.	Sekretariati OSHP-se.	i
MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E PLANIT TË INTEGRITETIT	Mungesa e zyrtarit përgjegjës për integritet	Ligjet dhe aktet nënligjore; Raportet periodike; aktet e brenshme rregulluese	3	8	24	Emerimi I zyrtarit përgjegjës për monitorim dhe zbatim të planit të integritetit	Sekretariati OSHP-se.	i
	Mungesa e njohurive të stafit OSHP-se, për integritetin	Raportet periodike; aktet e brenshme rregulluese	3	7	21	Organizimi i trajnimeve të stafit lidhur me informimin për integritetin dhe sjelljen etike.	Zyrtarja për integritetit. Zyra e burimeve njerzore	per
								Ne vazhdimësi



	dhe sjelljen etike						Shperndarja e planit te integritetit te stafi i OSHP-se.		TM1 - 2024
PROKURIMI PUBLIK	Mungesa e stafit per trajtim te lendeve brenda afatit ligjor	Ligjet dhe aktet nenligjore; Raportet periodike; aktet e brengshme rregulluese	7	8	56		Shtimi i numrit te stafit. Hartimi i planit te rekrutimit.	Sekretariati OSHP-se	Ne vazhdimesi
	Mungesa e kapaciteteve per pranimin e ankesave		8	8	64		Krijimi i nje sektori te vecant per pranimin e ankesave. Trajnime profesionale per stafin e ketij sektori.	Sekretariati OSHP-se	TM4 - 2024
	Mungesa e ndryshimeve te rregullores se punes		4	6	24		Miratimi i rregullores se re te punes se OSHP-se	Bordi i OSHP-se	TM1 - 2024
KONFLIKTIN INTERESIT	Mos identifikimi i te interesit ne trajtimin e ankesave		3	9	27		Nenshkrimi i deklarates nen betim nga stafi i OSHP-se per shmangie te konfliktit te interesit	Burimet njerzore	Ne vazhdimesi
	Mungesa e informimit te stafit lidhur me legjislacionin ne		3	8	24		Mbajtja e takimeve/trajtimeve per zbatimin e legjislacionit te ri qe lidhet me konfliktet e interesit	Burimet njerzore	Ne vazhdimesi

